

Në cilat raste duhet që adoleshentët dhe të rriturit të mos shkojnë në shkollë ose në punë dhe të testohen për COVID-19?




1. A ndiheni sëmurë apo a mendoni se po ju fillon ndonjë infeksion?



Rrini në shtëpi.
Flisni me mjekun nëse ju duhet ndihmë.



2. A keni temperaturë, kollë, dhimbje fyti, vështirësi në frymëmarrje, a keni humbur ndjesinë e shijimit/nuhatjes, ose a dyshoni se keni COVID-19?



Po


Kontaktoni qendrën e testimit për të bërë një testim.
Qëndroni në shtëpi derisa të dalin rezultatet e testit.



Jo

Mund të ktheheni në shkollë ose në punë kur të mos keni simptoma.

3. A u konfirmua në test se keni COVID-19?



Po

Duhet të izoloheni.
Komuna juaj do t'ju ndjekë juve dhe kontaktet tuaja të ngushta.



Jo

Mund të ktheheni në shkollë ose në punë kur të mos keni temperaturë dhe kur të ndiheni mirë.
Një kollë e lehtë apo kollë e ngjashme që zgjat nuk është problem.